



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË



Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenit 8 të Rregullores së Ministrisë së Financave dhe Transfereve Nr.04/2017, të datës 13.06.2017, mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Rregullores Komunale për Ndarjen e Subvencioneve, nenit 44, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për anëtarë të Komisionit për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve dhe individëve të pranuar sipas Thirrjes Publike të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Njoftohen përfaqësuesit e OJQ-ve dhe të shoqërisë civile që veprojnë në Komunën e Fushë-Kosovës, të cilët kanë aplikuar sipas thirrjes publike të datës **15.07.2025**, se mund t'i dërgojnë propozimet e tyre për të përzgjedhur anëtarët e Komisionit Vlerësues i cili do të themelohet për të vlerësuar aplikacionet për financimin e OJQ-ve për projekt-programet që kontribuojnë në avancimin dhe afirmimin e kulturës, rinisë dhe sportit.

Ky komision **do të plotësohet me** dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm të cilët nuk janë nën hetime apo me procedurë penale dhe që kanë përvojë në shoqëri civile me përparësi nga OJQ-të që merren me fushën e kulturës:

- Një përfaqësues nga OJQ-të, dhe
- Një përfaqësues në cilësinë e ekspertit.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të angazhuarit në Organizatat Joqeveritare aktive që veprojnë në Komunën e Fushë Kosovës;
- Ekspertë të pavarur të cilët kanë përvojë pune që ndërlidhet me hartimin dhe menaxhimin e projekteve në fushën e kulturës.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë diplomë universitare.
- Të kenë përvojë në hartimin dhe menaxhimin e projekteve të OJQ-ve kulturore.
- Të mos jenë të emëruar politik, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një CV.
- Përfaqësuesi nga OJQ-të duhet të dorëzojë një letër nominimi nga udhëheqësi i OJQ-së në të cilën dëshmohet se aplikuesi është i punësuar apo angazhuar në Organizatë.
- Përfaqësuesi në cilësinë e ekspertit duhet të ketë diplomë universitare në fushën e arteve, kulturës apo sportit.

Dokumentet e kompletuara duhet t'i dorëzoni në Zyrën Pritëse në ndërtesën e Komunës së Fushë-Kosovës nga data : 15.07.2025 deri me datë: 17.07.2025.

Nr.58/2025

Fushë-Kosovë

